



30. April 2020

Letër prindërve për fillimin e mësimit shkollorë (Version i shkurtë)

Të dashur prindër dhe persona me të drejtë kujdistarie,

ne deshirojmë t'ju informojmë, se mësimi për fëmijët tuaj do të filloj përsëri në shkollë.

Mësimi në shkollë nuk fillon në të njejtën ditë për të gjithë fëmijët.

Shkolla e fëmijës suaj do t'ju informojë juve, se në cilën ditë duhet të shkojë fëmija juaj përsëri në shkollë.

Rrugës për në shkollë (autobus/ tren) fëmija juaj duhet të mbajë një maskë mbrojtëse.

Distanca dhe higjena janë shumë me rëndësi: Shkolla do t'i shpjegoj fëmijës suaj se si duhet t'i lajë duart, të kollitet, teshtitet dhe si t'a mbajë masken që t'a mbulojë gojen dhe hunden.

Ditën e parë në shkollë fëmijët mësojnë rregullat për distancën e mbajtjes në klasë, në pauzë dhe në tualet.

Nëse fëmija juaj është i semurë, nuk lejohet që të shkojë në shkollë.

Nëse ju nuk jeni të sigurt, se a duhet fëmija juaj të shkoj në shkollë për shkak të një sëmundje në familje, telefononi paraprakisht në shkollë.

Këshilla të përgjithshme për higjienën në disa gjuhë dhe lidhje të tjera mund të gjenden gjithashtu në:

<https://migration.bildung-rp.de/>

dhe në:

<https://schuleonline.bildung-rp.de/unterstuetzung-fuer-eltern-und-schueler.html>

Shumë faleminderit për mbështetjen dhe të gjitha të mirat për ju dhe familjen tuaj në këtë kohë të vështirë.

.

Mit freundlichen Grüßen

In Vertretung



Raimund Leibold